

3219 / 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Nr. 3219/3 i Vendimit

VENDIM
I
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 27 / 12 /2006, unë Teuta HOXHA, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e bërë nga ana e kërkueses. Znj. Narciza Gemini, me cilësinë e administratores së shoqërisë tregtare "PRODENTALFARMA" Sh.p.k., mbi depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, datë 01.04.2006,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria Tregtare "PRODENTALFARMA" Sh.p.k., është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 3219, të vitit 1993 dhe ushtron aktivitetet e saj sipas akteve të themelimit dhe legjislacionit në fuqi.

Kërkuessa, Znj. Narciza Gemini, me cilësinë e administratores të shoqërisë tregtare "PRODENTALFARMA" Sh.p.k. kërkon depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, datë 01.04.2006.

Me anën e këtij Vendimi, Ortakët e Shoqërisë kanë vendosur për shitjen e e kuotave të shoqërisë në masën 100% të kapitalit themeltar në favor të personave të tretë jashtë shoqërisë, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Ortakët Narciza Gemini, zotëruese e 21.25% të kuotave, Roberto Volpini, zotërues i 21.25% të kuotave, Pietro Massi zotërues i 21.25% të kuotave dhe Giuseppe Piermattei zotërues i 21.25% të kuotave, Nikolla Cama zotërues i 10% të kuotave dhe Skënder Durrësi zotërues i 5% të kuotave kanë vendosur të tërhiqen nga Shoqëria duke shitur kuotat që ata zotërojnë në total në masën 100%, në favor të blerësit, Shoqërisë Tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k. Nga ana tjetër Shoqëria "ALDOSCH" Sh.p.k. ka miratuar blerjen e kuotave sipas vendimit të Ortakut të Vetëm, datë 30.03.2006.

Kështu, konform Kreut IV, neni 45, të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" është përpiluar para noteres Neriman Marika, kontrata e shit – blerjes së kuotave për masën 100% të kapitalit themeltar, e datës 01.04.2006 me nr. 1158 Rep dhe nr. 128 Kol.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë "PRODENTALFARMA" sh.p.k., datë 01.04.2006, është plotësisht e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr.7667, datë 28.01.1993 "Për Rregjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare",

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqërisë "PRODENTALFARMA" Sh.p.k., datë 01.04.2006, për shitjen e 100% të kuotave të shoqërisë që do të shiten nga ortakët Narciza Gemini, Roberto Volpini, Pietro Massi, Giuseppe Piermattei, Nikolla Cama dhe Skënder Durrësi në favor të Shoqërisë Tregtare "ALDOSCH" Sh.p.k., e cila bëhet zotëruese e 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë dhe cilësinë e ortakës së vetme të shoqërisë.
Depozitimi i kontratës së shit-blerjes së kuotave në masën 100% të kapitalit themeltar, e datës 01.04.2006 me nr. 1158 Rep dhe nr. 128 Kol. e hartuar para Noteres Neriman MARIKA.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrin Tregtar të pasqyrojë ndryshimet e mësipërme në kollonat përkatëse.

Kundër vendimit lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE

Teuta HOXHA